10/10/2022

# 30 VJET NGA STUDIMET NË SEMINARIN TEOLOGJIK “NGJALLJA E KRISHTIT”, DURRËS 1992 – 2022



Nisi me Festime 30 vjetori nga studimet në Seminarin Teologjik “Ngjallja e Krishtit” në Durrës. Studentët e viteve 1992 – 1995 u mblodhën sot në ambientet e kompleksit të Manastirit të Hirshëm të Shën Vlashit në Durrës.

Kremtimet nisën me Shërbesat e Shenjta – Shërbesa e Mëngjesores dhe Liturgjia Hyjnore në praninë e Episkopit të Bylisit Hirësi Asti.

Në fund të Liturgjisë u krye Shërbesa e Përshpirjes në kujtim të kontribuesve në mësimdhënie Episkopë, ish studentë klerikë më pas dhe pedagogë. U kujtuan në lutje Episkopët i Apollonisë Hirësi Kozmai dhe Hirësi Ilia Katre i Filomeliut, Priftërinjtë Atë Parashqevai, Atë Mitrofani, Atë Mihal Vasili, Atë Dhimitraq Kushi, Atë Spiro Papa dhe Atë Mihal Vasili dhe Pedagogët Dhimitër Beduli, Teodor Papapavli, Harilla Papajorgji, Maksim Çuko dhe Vasil Tushi.

Mbas Shërbesave klerikët dhe teologët vizituan ambientet e Manastirit të “Grave Miroprurëse” ku u mirëpritën nga Motër Rakela. Më pas të gjithë së bashku u mblodhën në sallën e pritjeve të Akademisë Teologjike ku bashkë me ta ishin të pranishëm Mitropoliti i Fierit Hirësi Nikolla dhe Episkopi i Bylisit Hirësi Asti. “Nisja e rrugëtimit të priftërimit pas përndjekjes ateiste” ishte titulli i temës që referoi

Episkop Asti. Gjithashtu Mitropoliti i Fierit Hirësi Nikolla i cili është edhe drejtori i Akademisë Teologjike kumtoi temën "Seminari Teologjik – Hieratik më pas Akademia Teologjike, fidanishte e përgatitjes së kuadrove të Kishës sonë".

Vijoi takimi me kujtimet dhe mbresat nga klerikët Atë Stavri Çipi, Atë Kostandin Prifti, Atë Petro Semsia, Atë Gjerasim Çakalli etj.

Kjo ditë ishte e veçantë për gjithësecilin që mori pjesë në këtë vit jubile. Vlerësimi për Kryebariun e Kishës sonë ishte mjaft i madh edhe kryefjala e të gjitha kumtesave, kujtimeve, vlerësimeve ishte Kryepiskopi i Tiranës, Durrësit edhe i



ë nga gërmadhat.

dhe të reja besimtarë që të

horet për t'i shërbyer Kishës

t.

























VITI I DYTE 1992-1995
Kryepiskopi Anastas
Atë Kostandin Prifti
Atë Kostandin Doko
Miron Çako
Atë Mihal Zingo
Alfred Bushaka
Atë Sotiraq Prifti
Atë Spiro Papa
Simon Avdia
Atë Thoma Bame
Atë Kristo Sharko






















METROPOLIS
PALACE
METROPOLIS
PALACE



Radio “Ngjallja”